



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 44

Datë: 06. 09. 2017, ora: 16:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP

Përkthyes: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.42 dhe 43/2017:

2.Aktivitetet e ZRPP-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikim të kandidatëve shtesë për Kuvendin Komunal në Vushtri

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të ZRPP-së për de certifikimin e kandidatëve të subjekteve politike, për zgjedhjet lokale 2017;

3.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore

- Shqyrtimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtareve të Kuvendit në Dragash dhe Mitrovicën e Veriut dhe Prishtinë;

-Shqyrtimi i kërkesë për nivelizimin e pagës së Koordinatorit të QNR-së me Drejtorët e Departamenteve;

4. Të ndryshme.

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.42 dhe 43/2017:

Valdete Daka: E kemi rendin e ditës...! A ka ndokush ndonjë propozim, sugjerim...? Nëse jo, në rend janë procesverbalet e mbledhjes së KQZ-së nr.42 dhe 43/2017.

Anëtarët e KQZ-së, fillimisht miratuan rendin e ditës, dhe pastaj miratuan edhe proceverbalet e mbledhjeve nr.42 dhe 43/2017 të KQZ, me vërejtje teknike të anëtarit, Eshref Vishi.

2. Aktivitetet e ZRPP-së

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të ZRPP-së për de certifikimin e kandidatëve të subjekteve politike, për zgjedhjet lokale 2017

Valdete Daka: Urdhëroni drejtoreshë...

Miradie Mavriqi: Duke u bazuar në Ligjin për Zgjedhje, kandidatët të cilët aplikojnë për certifikim d.m.th., mund të tërhiqen nga gara zgjedhore dy ditë para tërheqjes së shortit. Kemi kërkesat e 18 kandidatëve të cilët kanë bërë kërkesë për tërheqje nga gara zgjedhore. Në bazë të arsytimeve, kanë bërë me shkresë kërkesat d.m.th., konform me ligjin, dhe zyra rekomandon që të de certifikohen kandidatët të cilët janë në listën që e keni ju në rekomandim. Janë plotësuar kushtet e parapara me ligj. Edhe një herë po e ceku, kryetare..., nëse dëshironi mund t'i lexoj, vetëm i keni emrat...

Valdete Daka: Kush është për de certifikimin?

Betim Gjoshi: Ne, e kemi pasur një diskutim në takim dje, dhe jemi marr vesh rreth kësaj çështje që ne me ju dhënë një afat partive kur m'i zëvendësua këta persona, dhe nuk e di a kanë menduar në rekomandim nuk e pash ndoshta e kam gabim, por, nuk do të thotë kur këta mund t'i sjellin mi zëvendësuar këta persona. Ndoshta, kishte qenë mirë me iu dhënë dy ditë punë ose më ju dhënë një ditë pune, ose prej sodit, ndoshta edhe i kanë sjellë por, ne kishte qenë mirë në vendim se ne po i certifikojmë se sot fillojnë me rrjedh gjërat, pas de certifikimit me ju kërkua me i zëvendësuar këta persona. Mirë kishte qenë me ju lënë 24 orë deri nesër në fund të orarit...

Adanan Rrustemi: Është edhe një dokument ç'është e vërteta, pajtohem me atë çka tha Betimi. Këto janë kërkesa vullnetare për tërheqje, dhe njoftimi i subjekteve politike fillon nga ky moment d.m.th., nga de certifikimi. Pra, ne e bëjmë de certifikimin emër për emër. Jemi pajtuar deri të premtën me pas mundësi mi sjell zëvendësimet të paktën në diskutimin që e kemi pasur dje. Unë, e kuptoj njëfarë qasje të zyrës për ta ekonomizuar kohën, por, janë absurde disa afate që po ju jepni partive politike brenda 24 orëve që janë të bazuara në asnjë ligj asnjë nen, në asnjë vendim të KQZ-ës. Unë, e di po mundoheni mi përfund sa më shpejt edhe me pas kohë për ti certifikuar por, kur të thuash brenda 24 orëve pastaj nuk duhet m'i pranuar pas 24 orëve. Por, kur të ju thuash brenda 24 orëve duhet me bazu atë 24 orëshin diku. Kemi pasur situata të tilla, edhe në fazën e përmirësimit të plotësimeve kur i kanë pasur partitë politike tri ditë, katër e pesë, ju kemi dhënë 24 orë e 48 orë e kështu me radhë. Ndërsa për pjesën e dytë, rekomandimi është i ndarë d.m.th., sado që është në dokument. Ne, duhet me e nda, ne duhet m'i miratuar rekomandimin për tërheqjen e këtyre kandidatëve dhe kërkesën për zëvendësim, ndërsa kjo pjesa tjetër që nuk është rekomandim por më tepër njoftim, dhe..., me diskutuar se si po vendosim, se ne e kemi qëndrimin.

Binak Vishi: Akti i dorëheqjes është akt individual, edhe mund të jetë..., partitë politike mund të jenë të pa njoftuara se dikush ka dhënë dorëheqje dhe nuk mund të jetë pjesë e listës së certifikuar. Kështu që ne, duhet të jemi të saktë në afatet që ju japim edhe t'i njoftojmë subjektet politike për të gjitha afatet që i ndryshojmë, pos afatit që e kemi pasur afate që i kemi pasur deri me 3 shtator, kur e kemi shtyrë afatin i kemi njoftuar në nivele komunale por, nuk i kemi njoftuar partitë politike në nivel qendror për afatet të cilat janë ndryshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Pa parit politike nuk ka kuptim, këto janë akterët kryesor në proces zgjedhor. T'i njoftojmë parit politike me afatet e ndryshuara të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe me oraret e reja të paraqitura dhe me vendimet pse kanë ndodhur këto. Sepse, shpesh po na thonë se pse është shtyrë ky afat, e ne po duhet të ju kontaktojmë juve me ditë saktë se pse janë shtyrë afatet dhe çfarë afate ju keni dërguar nëpër komuna.

Miradije Mavriqi: Kur është miratuar një plan operacional kanë qenë edhe afatet e caktuara d.m.th. edhe për tërheqje të shortit edhe varësisht prej këtyre aktiviteteve tjera siç është aplikacioni për certifikim deri në momentin e fundit edhe sa ditë ju ka dhënë zyrës d.m.th. për kontrollim të këtyre dokumentacioneve edhe sa ditë ju ka dhënë subjektit politik është me ligj sa ditë ju jepet faktikisht në bazë të ligjit sa ditë ju jepet për plotësimin e dokumentacionit. Ne, jemi munduar mirëpo tash ka ndodhur një çrregullim sepse janë tejkaluar ato afate, edhe në atë kuptim te zyra me pas mundësi me ju përmbajt atij afati për tërheqje të shortit, për renditje të subjekteve politike ju kemi dhënë një afat sa më të shkurt që është e mundur kjo është arsye asnjë arsye tjetër.

Betim Gjoshi: Ne, e kemi para vetit një rekomandim numër një që zyra veç e referoj, ky rekomandim unë e thash një here e ka të mangët afatin, afatet që sot i vendos në këtë rekomandim nuk e tregojnë shortin, short na i kemi thirr numrat për subjekte jo për kandidat d.m.th., na deri të premtën ose të enjten kur doni ju lëmë një afat po duhet me u bërë pjesë e këtij, se kur e bëni draftin vendimin me ta, kur certifikohen, këta u jepet partive kaq për arsye të ruajtjes së kuotës për zëvendësim të tyre d.m.th., kjo duhet me qenë...Ta qesim këtë në votat në vazhdim e bisedojmë tani me rekomandimin e dytë ma tutje.

Adnan Rustemi: Ne, duhet me marr një vendim të veçantë për tërheqjen e këtyre kandidatëve dhe certifikimin e këtyre kandidatëve me arsyetimin e tërheqjes së këtyre. Nuk e di, meqenëse veç është tërheqja, morëm vendim për secilin kandidatë apo së paku për secilin subjekt politik që me u njoftuat për zëvendësime. Në parim, si është dashur për secilin kandidatë me marr arsyetime se është i njëjtë edhe me i shkruar secilin sa më të veçantë edhe aty figuron afati deri kur , në shkresën me subjekt politik deri ku mundet ta plotësoj.

Miradije Mavriqi: Secili, ka me pas vendimin e vet kuptohet, se nuk mund të jetë një vendim i përbashkët për të gjitha emrat. Mirëpo, rekomandimi si rekomandim është kështu i përgjithshëm...

Nenad Rikallo: Ky proces, nuk është i përfunduar. Njëzetë e katër orë, kandidatët kanë kohë...dhe, njerëzit e tjerë mund të zëvendësohen...Nëse e bëjmë 48 orë tërheqjen para shoritit, atëherë duhet ta bëjmë për të gjithë kandidatët...

Valdete Daka: Nenadi e ka mirë, sepse po thotë në qoftë se e bëjmë 8 orë tërheqjen para shortit, atëherë duhet ta bëjmë për të gjithë kandidatët, për 7 mijë kandidat. Me ju lënë mundësin që prapë 48 orë para të 11, e ne po themi jo...

Betim Gjoshi: Por, ne jemi duke folua për afate të ndryshme. Afati 48 orë për tërheqje ka përfunduar, ne po flasim për zëvendësim... Këta kanë aplikuar brenda afatit 48 orë për tërheqje, ne po flasim për zëvendësim të tyre që nuk ndërlidhet me shortin zëvendësimi d.m.th. se ai nuk e pengon zëvendësimin. Ky afat ka përfunduar, ne e kemi shtyrë shortin për shkak të Vushtrrisë, jo për shkak 48 orshit të tyre, d.m.th. që të jemi të qartë. Ka përfunduar, nuk mund të tërhiqet më askush. D.m.th. të hënën ne e kemi shortin, edhe kjo nuk na pengon asgjë, ata mi certifikuar të premten , m'i certifikuar të shtunën edhe mi certifikuar të hënën...

Ilir Gashi: Kryetare, vetëm një sekondë. Për ta pasur të qartë Nenadi...se, ne këtyre çka janë tërhequr ju kemi dhënë edhe një afat sa për ti zëvendësuar vetëm këta çka janë këtu, dhe atë e kemi shfrytëzuar rastin e Vushtrrisë që edhe këta që janë tërhequr sepse nuk kanë pasur të drejtë të zëvendësohen d.m.th. ekskluzivisht vetëm për këta që janë tërhequr numrat e tyre që të plotësohen, nuk ka të bëjë me asnjë kandidat tjetër asnjë një mundësi tjetër se kanë përfunduar ato. Pyetje për drejtoreshën. Ka pasur një komunikim edhe fizik edhe me shkresa me BZAP-in lidhur me tërheqjen e kandidatëve, a ka mundësi një informacion të shkurt se çfarë është bërë me ata që kanë bërë kërkesa në BZAP-ë apo në ZRPP-ë për tërheqjen, ku jemi me dy kategoritë?

Eshref Vishi: Ka pas një komunikim edhe fizik edhe me shkresa me PZAP lidhur me tërheqjen e kandidatëve...Për drejtoreshën, a mundeni me na dhënë një informacion...?

Miradije Mavriqi: Ndoshta ka ndodhur, kështu gabimisht ose e kanë bërë kërkesën të PZAP-i pastaj PZAP-i i ka dorëzuar te ne, nuk është ndonjë problem.

Bajram Ljatifi: Kjo që po bisedojmë, ka një interes vetëm brenda nesh...Ne, duhet ta rregullojmë: ky 48 orë, është i bazuar në ligj dhe ne nuk mund ta ndryshojmë...! Nuk kemi marrë marr vendim...

Valdete Daka: Ta votojmë këtë. Atëherë kush është për..?

Sami Hamiti: Po vazhdojmë me pjesën e dytë të rekomandimit. Prezanton drejtoresha...

Valdete Daka: Silli emrat Miradi, edhe aktgjykimet...Komplet...!

Betim Gjoshi: Një takim po themi që emrat është përgjegjësi ti kemi ne, një takim po themi nuk është mi pas, kemi me mbajtur edhe nesër mbledhje edhe pasnesër. Ne e kemi rekomandim para vetit, rekomandimi e pat një vërejtje prej kolegut që e është me shumë të drejtë që nuk është i plotë, që nuk është bërë në mënyrën si duhet se nuk janë kategori të njëjta. Është dashur të jetë një rekomandimi i veçantë, është dashur të jetë edhe rend ditë i veçantë por, e kemi kështu. Na prezanton drejtoresha, vardojmë ne me diskutimet tona, merret një vendim për rekomandimin e parë edhe përfundojmë me këtë punë...Të mos e tensionojmë situatën...Kam respekt...Marrim vendim në bazë të gjithë diskutimeve...

Sami Hamiti: Aktvendimi është i mangët...

Adnan Rrustemi: Bëjeni autorizimin me shkrim...

(Sami Hamiti, e kryeson mbledhjen në mungesë të kryetares...)

Sami Hamiti: Vazhdojmë me pjesën e dytë të rekomandimit të ardhur...e prezanton drejtoresha...

Miradije Mavriqi: Zyra, duke u bazuar në aktgjykimet përfundimtare të gjykatës themelore të Republikës së Kosovës, ka evidentuar që 80 kandidatë të subjekteve politike kanë aktgjykim përfundimtar, andaj duke u bazuar në nenin 29 pika 1 në ligjin për zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës e parasheh që kur një person nuk është i aftë për certifikim d.m.th. është i shpallur fajtorë për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit, andaj zyra i rekomandon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të de certifikoj nga lista zgjedhore numrin e kandidatëve të shënuar nga subjektet politike si në vijim. Ju, i keni të renditura të gjitha subjektet politike nga sa kandidatë d.m.th. për rekomandim për certifikim. Ne, nuk i kemi sjell ende, kemi parë që edhe kemi biseduar këta të gjykatave kemi parë që edhe aktgjykimet kur janë të publikuara...nuk ka pasur asnjë presion prej askujt vetëm prej asaj e kemi nis dhe e kemi marrë, ju i keni ato subjektet politike dhe secili nga ju i keni emrat e kandidatit. Kështu që, ju e shihni të arsyeshme dhe i shikoni se si janë certifikuar, dhe sa i përket asaj teknikisht asaj çështje. Faleminderit

Ilir Gashi: Faleminderit, jo veç desha ta pyes Zyrën nëse, a mund të garantoj në bazë të këtyre numrave që i kanë sjell të gjithë këta prej 80 vetave janë të dënuar ashtu siç është e shkruar, e kanë formën e prerë të vendimit..., a ka të atillë që mund të jenë të liruar ndonjë gjykatë tjetër një shkallë tjetër e gjykatës siç, është shkalla gjykata e Apelit...A ka ndonjë gjykatë tjetër e cila, ende nuk i ka pru përgjigjet e kërkuara.

Adnan Rrustemi: Jo së pari të gjithë e dimë që i certifikojmë subjektet politike, certifikojmë kandidat, de certifikojmë subjektet politike, de certifikojmë kandidat, nuk de certifikojmë numrat, d.m.th., proceduralisht pavarësisht a i kemi informatat a si kemi etj., madje vetë dokumenti vjen ndeshje me pjesën e parë si praktike, si start. Për m'u lidh për ata se çka e thash d.m.th., për me konstruktive një herë

këtë aspektin e jo gjithë përfshirjes, mungesës së dokumentacioneve, dokumenteve të pa plotësuar, unë se paku pe shoh për rastin e lëvizjes Vetë Vendosi jone 5 këtu, unë gjithë ditën kam qëndruar në zyre të drejtoreshës...I kam thënë, gjemi dy aktgjykime për pesë rastet, m'i kanë gjet vetëm për 3 raste këtu është drejtoresha, ja kanë b'a minus komente me tabelë... Për dy rastet s'ka aktgjykime edhe e kemi prapë këtu si shifër po besoj që është për qata të 5-it dhe, s'ka dy tjetër që janë shtue se, s'ka informacion d.m.th., kjo e para për aspektin procedural, e dyta për aspektin përmbajtësorë. Unë, d'u me thanë për mendimin tim, pavarësisht numrit, unë nuk e di..., për me e ditë së paku për këta të tre, unë mendoj, pavarisht nenit 21 pika F, nëse nuk gaboj që flet në një mënyrë për përshtatshmërinë...

Unë mendoj, tha z. Rrustemi se, e para e nenit është arbitrare, bjen ndesh në disa mënyra të dispozitave ligjore. Kisha filluar prej nenit 45 të Kushtetutës: çdo shtetas i Kosovës që ka arritur moshën 18 vjeçare deri në ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedh me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor, është neni kushtetues i cili informon në raste të tilla, ku vet gjykata nuk i ka përdorur këtë të drejtë të vetës me kodin penal për dënim plotësues. Pra, e dënon dikë në komunikacion për një veprim por ja merre lejen me dënim plotësues për dy vjet, nuk e len me vozitë ja merr edhe lejen e vozitjes... Në rastin tjetër, për t'ju referuar Kodit Penal, neni 63..., flet për heqja e të drejtës për t'u zgjedhur: ekskluzivisht, i hiqet kryesisht të veprës penale zgjedhja prej një, deri në katër vjet, ndërsa ai person me qëllim të zgjedhjes kryen vepra penale kundër të drejtave, sepse kjo ishte për të drejtat e njeriut. Vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku dy vjet, ka kategorizime këtu. I njëjti kod penal, na thotë se për pasojat juridike të dënimit i shqiptohet gjoba me kusht, ose kryesi lirohet nga dënimi. Ne, e kemi parë që 90% të rasteve i kemi ose me gjoba, ose me dënim me kusht: nga dy muaj për raste të komunikacionit, për energji elektrike etj. Personalisht, jam kundër, jam i bindur për këtë punë edhe për faktin që mendoj se kandidatët mundën t'i ndjekin të drejtat të apelimit të KQZ-së edhe me i ftuar instancat e Gjykatës Kushtetuese... Dispozita, është në kundërshtim, jam shumë i bindur prandaj, jam edhe kundër këtij rekomandimi....

Eshref Vishi: Unë, prapë..., mbase e nisen kolegët me pyetje...Edhe unë, po e nisë me pyetje pa hyrë në komente...Unë, kam një pyetje për drejtoreshën: A jemi në rregull në kuptim të procedimit me këtë rekomandim, edhe duke marrë parasysh njoftimin paraprak të subjekteve politike që të kenë kujdes për përfshirjen e listave të kandidatëve në procedim penal se, do të vijmë në këtë pikë dhe nuk ka kthim mbrapa...Dhe se Gjykata Themelore apo Këshilli Gjyqësorë, a ju ka përgjigje kërkesës së KQZ-së për regjistrimin e partive politike të gjitha rastet me precedent penal, apo jemi në pritje të informacioneve shtesë nga gjykata...

Miradie Mavriqi: Përpos gjykatës themelore të cilën e ka dorëzuar vetëm një listë me emra, dhe thotë se është një akt gjykim i formës së prerë dhe nuk e kemi marr as një i formës së prerë që i kanë dorëzua aktgjykimet...Ne, i kemi marr me emra ashtu siç janë të dorëzuar aktgjykimet të formës së prerë, gjykatat e tjera që i kanë dorëzuar në formë të aktgjykim, na ato i kemi marrë parasysh...Gjykata e Prishtinës nuk i ka dorëzuar aktgjykime...

Betim Gjoshi: Gjykata e Prishtinës nuk ka dorëzuar, por as nuk thotë se janë aktgjykime të

prera...Është një listë dhe një procedurë, dhe nuk thotë se është një aktgjykim... Merrne shkresën këqyrni se e kemi edhe ne...

Eshref Vishi: E dëgjova me vëmendje drejtoreshën se, thotë që janë si të mangëta listat që vijnë nga gjykata themelore për rastin e Prishtinës që për mendimin tim është shumë shqetësuese për ne si anëtar të Komisionit të Zgjedhjeve në aspekt të vendimmarrjes... Përkundër asaj, unë e pranoj që kemi kontaktuar me zyrën...mirëpo, ajo që u tha se janë të mangëta..., është vërtetuar...Unë e kam vërtetuar me një rast konkret, e nuk e di nëse ai rast është përfshi në listën e subjektit tim politik apo jo...Gjykata themelore në Prizren, e sjell një rast me procedim penal në kuptimin e plotfuqishëm të aktgjykimit, ndërsa pala m'u ma sjell një vendim të Apelit që është i liruem... Do të thotë, Gjykata themelore në Prizren ka marrë një vendim që është liru nga vepra penale...Prokuroria, e ka ngritë rastin në apel edhe ja ka refuzuar, dhe këtu vjen lista..., çka s'po mundem me kuptue..

Binak Vishaj: Faleminderit...Paraprakisht, për listën e emrave të partive politike, personalisht unë i kam thënë partisë sime se ata nuk kanë nevojë asnjë kandidat me e zëvendësuar, sepse ne i kemi certifikua kandidatë e tyre dhe nuk kanë nevojë me e sjellë asnjë emër... I vetmi institucion që e bënë de certifikimin është KQZ dhe, asnjë institucion tjetër...Dhe, sot nëse KQZ e de certifikon listën marrim vendim me ua dërguar partive...Por, personalisht po them se na keni sjellë shumë problem...

Unë, tha z. Vishi, e kam një vendim të Gjykatës së Gjakovës të viti 2009 dhe, kandidatit që ju ka shqiptue ky aktgjykim nga kjo gjykatë themelore është i para 3 viteve. E sjellë vërtetimin nga e njëjta gjykatë që nuk është i dënuem, dhe ky person e ka emrin në listë...Unë, nuk kam dyshimin se janë informatat e sakta..., por unë e kam dyshimin se informacioni nuk është i plotë prej krejt gjykatave që i përfshinë krejt partitë politike, të gjitha subjektet politike...Ka gjykata që nuk i kanë pru për krejt subjektet politike, por për një pjesë të tyre...dhe unë, nuk i japë të drejtë vetës me e ngritë dorën...sepse, nuk dua ta shkelë një të drejt civile, kushtetuese të askujt...

Betim Gjoshi: Unë, i kam dëgjuar me kujdes kolegët gjatë ditës, jam ballafaquar me njerëz, me dokumenta që i kanë sjellë dhe që ne i kemi kërkuar...Është e vërtetë që janë ngut me i prue dëshmitë me i verifiku edhe me ja dorëzuar partive, se edhe ashtu ligji thotë. Pas shumë diskutimeve, jemi në dilema d.m.th., dilemat e para janë se ne jemi te disa persona që kanë dosje të cilët për shembull, kanë ble n'i telefon të vjedhur edhe e kan pagu dënimi 120 euro, dhe dëshmitë e atij personi që ja ka shitë janë problem...Sot, patëm kohë me e këqyrë ligjin për deputet dhe për zgjedhje lokale, dhe përnjëmend është dilemë çka mendoj unë..., dhe mendoj se është dashur me bërë n'i prerje edhe me e gjete një mekanizëm të komisionit zgjedhor për me e zbatuar ligjin...Ka pas tentativë për këto zgjedhje por shihet se mbas këtyre dilemave jam i mendimit që, a po bëjmë mirë apo keq nëse i hjekim këta 10...Ne, prapë s'po e përfundojmë punën 7 dit mbas certifikimit. Në qoftë se na sjellin gjykatat mbas 7 ditëve, ne prapë kena mu marr..., dhe në qoftë se na ndodh ndonjë ankesë prapë po e rrezikojmë procesin, dhe na shtyhet procesi...

Jemi ardhë në këtë situatë, dhe duhet me ba n'i zgjidhje. Të gjithë diskutimet e kolegëve, shumica që folën, i kanë shqetësimet e tyre...Sot, ne nuk i certifikojmë këta njerëz, duhet me ju dërguar një shkresë partive politike..., se a jeni në rregull, ose është në vullnetin e juaj nëse doni ose, me gjetë një modus...Ne, nuk e dimë cila, apo çka mendon...Ne, vetëm mundemi me marrë një vendim arbitrar, e ne s'mund ta marrim një kësi vendimi...

Eshref Vishi: Pa e komentuar Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme që e kemi për obligim me e zbatuar, ligji, përkatësisht neni përkatës..., pa hy në komentimin e akteve ligjore, është e vështirë të bindet njeriu për t'i shkurtuar një të drejtë subjektive ose një kandidati me një ngritje dore...Para vetës, kemi mjaftë dilema të cilat u ngritën këtu, duke i përfshirë edhe zyrat edhe kolegët anëtarë të komisionit zgjedhorë të zgjedhjeve, ku secili prej nesh mundë të kryej një vepër penale për të cilën ne kemi pasur dëshmi për të parë se për çfarë veprash penale...Shumica dërmuese e aktgjykimeve, do të thotë edhe ne mund të jemi pjesë e veprave tëqë janë thjeshtë, pjesë e një rrezikshmërie të një aktgjykimi me gjobë të ulët...

Në këtë kuptim, tha z. Vishi, unë mendoj se ne nuk duhet të hyjmë në interpretim se, nuk jemi kompetent për ta ndryshuar normën mirëpo, normat përkatëse që është ligji për zgjedhjet është shumë e përgjithësuese! Absolutisht, nuk e kategorizon asnjë vepër penale, me vetë faktin se quhet vepër penale, me vetë faktin se kemi një aktgjykim për kryerësin e asaj veprë penale..., faktikisht i përfshinë të gjitha...Neve nuk na mbet as një alternative tjetër, përkundër asaj se ligjet alternative kanë një fleksibilitet edhe e trajtojnë ma ndryshe rastet që ne i kemi para vetës këtu...Unë i kam dilemat në vete dhe mundë të zbrapsem nga një vendim tjetër për cenimin e një të drejte të kandidatit, pavarësisht se cilit subjekt politik i takon...

ErcanSpat: Rekomandimi i zyrës e patë një qëllim shumë të mirë, një qëllimi fisnik: të e zbatojmë një nen ligji... Dhe, për botëkuptimin tim dhe të vetë KQZ-së edhe si shoqëri, duhet të shkojmë një hapë përpara...Mirëpo, me këto zhvillime të cilat i përjetojmë dy tri ditëve, apo edhe më gjatë mendoj se do të bëhet një gabim nëse ne një konditat ose një njeri, pavarësisht i merret e drejta që të kandidohet në zgjedhje...Unë personalisht, isha në pritje se do të mundemi që të jemi në gjendje të bëjmë një vi, përgjegjësia do të jetë dhe si institucion, por edhe si anëtarë të KQZ-së...Përshtypja ime është, dhe për këtë u binda sot se unë s'mendoj që duhet t'ia marrim kujdo të drejtën për të kandiduar, dhe unë nuk do të votoj për de certifikim...

Ilir Gashi: D'u me i thanë disa komente ose mendime të kësaj çështjeje...Unë, i kam dilemat e mia siç tha edhe Ercani...Ne, të gjithë kemi menduar mirë që të bëjmë një shkëputje ose një prerje mirëpo, hapin e kemi humbë...Mendimi im është se edhe si shoqëri, edhe si KQZ-së edhe si vendime të gjykatës më datën 11 qershor 2017...Është e pakuptim që kritere të tilla mos më pas për ata të cilët vendosin për fatin e këtij vendi të zgjidhen deputet, mbase me vepra po të njëjta, në mos më të rënda..., dhe ne me kritere të këtilla të vendosim për asamblistë komunale

për cilët, ne të gjithë e dimë përgjegjësia e tyre...! Pa dashur me e riaktivizuar çështjen, dilema tjetër është që ne të mos bëjmë precedent në kuptimit e të drejtës së dikujt, në emër të një qëllimi të mirë...! Unë e shohë që nuk ka kompletim të kësaj natyre që është kërkuar dhe si rrjedhojë, mbi bazën e një vendimi mund të ja cenojmë të drejtën njerëzve...

Ne, tha z. Gashi, e kemi pasur një rekomandim i cili thotë se kandidatët janë të gjithë në rregull, tash mbasi që e kemi verifikuar tash pasi që e kemi certifikua shkresat e ardhura nga gjykata nuk janë complete, dhe, edhe ato që kanë ardhur nuk janë me dilema se nuk janë të kompletuara..., unë mendoj që është bukur vështirë që ne të vendosim ndryshe nga ajo që kemi vendosur herën e kaluar kur kemi marrë vendim...

Mendimi im është që ne dhe zyra, t'i informojmë subjektet politike që ne mbrojmë vendimin paraprakë që këta kandidatë të jenë të certifikuar...Po ashtu, t'i informojë partitë politike që ta tërheqë vendimin që e ka dërguar dje, dhe që ne të vazhdojë më tutje në procesin zgjedhorë...

Sami Hamiti: Nga diskutimi edhe i përfaqësuesve politikë që janë këtu, duke filluar edhe prej subjektit tim që ka në atë listë...Kam po ashtu dëshmi që ato aktvendime ose të tejkalueme sepse, janë të viteve paraprake ose, që nuk ekzistojnë...! Po ashtu, unë nuk e di por drejtoresha...Qysh e hoqe Nismen...? A ta solli gjykata vendimin, a t'i i pae vetëm 2 letra dhe e hoqe prej liste...Në vendimin e Apelit...po themi se ka njësoj..., a i gjetët dy aktgjykimet...Në rregull, unë e pash një aktgjykim të vitit 2009, e pash tjetrin që e ka liruar Apeli, po e shohë tjetrin që i ka marrë vërtetim 3 vitet e fundit...Atëherë, kush do të jetë ai që do ta përcaktojë saktësinë...Mos u brengosni ju, sepse problemi nuk është te ju...! Faji i juaj nuk është në atë që ato nuk barazohen...Nesër secili prej tyre, e ka të drejtën dhe shkon deri në Kushtetuese...Dilema të cilat i kemi, e që kanë ardhur me shkresë janë dhe që na e prishin kompletë procesin...Në anën tjetër, disa gjykata nuk i kanë sjellur, dhe ne s'presim dhe kështu bëjmë pabarazi! Mendoj që ne nuk mund t'ia heqim të drejtën dikujt që të marrë pjesë në zgjedhje...! Nuk ekzistojnë kushte që me hamëndësim KQZ të votojë...Problemi është se, çka do t'iu sugjerojmë partive politike...Gabimi ka ndodhë, është dërguar shkresa pa marrë vendim...

Bajram Ljatifi: Duhet të jemi të vëmendshëm dhe t'i bëjmë llogaritë që të mbrojmë ligjin, kandidatët, vetën tonë dhe institucionin...Ne, si KQZ jemi në konflikt me interesin dhe ligjin...Nëse, unë do ta dënoj dikën apo, dikën ta lirojë...! Ne, duhet t'i mbrojmë edhe partitë politike, ashtu si edhe Zyren e Partive...Kemi nenin 100, pika 2 të Kodit Penal (Ai, e lexoi këtë nen...), prej të cilit shihet se, ky nen nuk interferon shkeljen e të drejtës sepse, kjo nuk konsiderohet si vepër penale...Është e turpshme që ne ti dënojmë njerëzit, kjo nuk konsiderohet vepër penale...Është e turpshme që dënimi me gjobë, të konsiderohet vepër penale...Madje, deri në 3 vjet...Pra, ne duhet të gjejmë vendim të drejtë, të sigurtë...Ne, kemi ardhur tash në këtë situatë, dhe ne nuk di se si do të marrim vendim...Dhe, kjo është e padrejtë që për një laps kimik, për një telefon t'ia marrim të drejtën dikujt që të mos kandidojë...

Ne, duhet të kemi kujdes, jemi në një situatë kur e cenojmë jo vetëm institucionin, por edhe integritetin tonë personal...Nuk është e drejtë, nuk është e drejtë...!

Sami Hamiti: Në mënyrë absolute, këtu jemi që me këto shënime nuk mund të de certifikohen njerëzit sepse, janë të pa saktë, të gjithë jemi deklaruar se nuk mund të votojmë... Si do ta formulojmë vendimin, është problemi dhe që askush të mos lëndohet, askush sepse nuk është problemi që këtu u nis m'u lënduar dikush, por dikush po e personalizojmë pa pasur nevojë...

Betim Gjoshi: Stenogrami, mendoj që merr kohë, na i kemi deklarimet..., në bazë të tyre shpejt shënojeni një arsyetim sepse, Zyrës i nevojitet shumë shpejt, në mbrëmje duhet me ua dërguar partive politike...Normalisht, që ne e formulojmë.... Po, ne e kemi një rekomandim zyrës se ne duhet me marr një qëndrim, kuptohet deklarimet i përfunduar...dhe në bazë të tyre ne duhet shkruar edhe një arsyetim sepse, duhet një shënim dhe një vendim...

Sami Hamiti: “Në bazë të diskutimeve nga secili anëtar këtu përveç kryetares që është në mungesë, është që nuk janë plotësuar konditat në bazë të shënimeve rekomandimeve dhe shënimeve që kanë ardhur nga gjykatat që nuk janë të plotësuara mirë, që kanë mangësi kanë vendime të vjetra që nuk janë të afatshme: Një zëri u pajtuam që në këtë formë nuk mund të bëhet de certifikimi i këtyre kandidatëve. Prandaj, sugjerojmë si konkluzion që zyra t'i njoftoj subjektet politike që të veprojnë sipas certifikimit të mëparshëm.”

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me vota unanime qëndrimin e tyre për të mos i de certifikuar kandidatët

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikim të kandidatëve shtesë për Kuvendin Komunal në Vushtrri

Sami Hamiti: Janë certifikuar kandidatët e mëparshëm. Për Vushtrrinë, a e keni parë për materialin për secilin kandidat. Kush është për, të certifikohen?

Anëtarët e KQZ-së, certifikuan kandidatët shtesë për Kuvendin Komunal në Vushtrre.

3.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtareve të Kuvendit në Dragash dhe Mitrovicën e Veriut dhe Prishtinë;

Sami Hasmiti: E kemi shqyrtimin e pesë kërkesave për zëvendësimin të anëtarëve të Kuvendit të Dragashit, Mitrovicës së Veriut dhe Prishtinës, po fillojmë me Prishtinën:

Rejhan Vuniqi emërohet anëtare për Kuvendin Komunal të Prishtinës nga partia AAR, dhe zëvendëson Sofie Bunjakun e cila ka dhënë dorëheqje për shkak të pozicionimit të ri. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim

Hebib Osmani, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal të Dragashit nga partia PDK dhe zëvendëson anëtarin e Kuvendit Komunal, Shaban Shabani. Kush është për të bëhet ky zëvendësim?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim

Aleksandra Bogusavleviç, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Veriut nga subjekti politik “Gracanska Iniciativa Srbska”, duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal Miliana Nikoliç. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim

Dragan Spasoieviç, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Veriut nga subjekti politik “Gracanska Iniciativa Srbska”, duke zëvendësuar anëtarin Komunal Zoran Niksholoviç. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim

Dejan Radojeviç emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në komunën e Mitrovicës së Veriut nga subjekti politik Gracanska Iniciativa “Esdepa Ilover Ivanoviç”, duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal, Igor Semiç. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim

Në fund të mbledhjes, pika e rendit të ditës: “Shqyrtimi i kërkesë për nivelizimin e pagës së Koordinatorit të QNR-së me Drejtorët e Departamenteve”, u shty për mbledhjen e ardhëshme. Në “Të ndryshme”, nuk pati diskutim.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare.....

Sami Hamiti, anëtarë.....